

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 8, neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 11 dhe neni 62, paragrafi (6) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 7 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-3506/2 datë 25.09.2023, përpiloi Tekst i pastruar nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

Teksti i pastruar nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, përfshin: Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio nr.01-5774/1 datë 21.11.2014, Rregulloren nr.01-3336/1 datë 08.05.2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio dhe Rregulloren nr.01-3539/1 datë 25.09.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

RREGULLORE
PËR KUSHTET MINIMALE TEKNIKE, HAPËSINORE, FINANCIARE DHE KADROVIKE PËR
MARRJEN E LEJES PËR EMETIM RADIO DHE TELEVIZIV
(Tekst i pastruar)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Kjo rregullore i përcakton kushtet minimale teknike, hapësinore, kadrovike dhe financiare, që duhet të plotësojnë radiodifuzerët që të emetojnë program në nivel lokal, rajonal dhe shtetëror

Kjo rregullore nuk ka të bëjë me radiodifuzerët, në pjesën e dispozitave për posedimin e detyrueshëm të hapësirave të studios apo atyre shtesë, në rast kur shërbimi programor përmban vetëm emisione që në tërësi përgatiten ose janë hapësira përgatitur në vend tjetër (program i specializuar muzikor, filmik ose sport, program i teleshoppingut etj).

Kjo rregullore në pjesën e hapësirave dhe parametrave themelor, nuk ka të bëjë me rastet kur emetimi, respektivisht incizimi, realizohet jashtë hapësirës së studios (stadium, manifestim kulturor ose sportiv, në hapësira të hapura, tubime të qytetarëve etj.)

II. KUSHTET E PËRGJITHËSHME PËR TË GJITHË RADIODIFUZERËT (RADIOT DHE TELEVISIONET)

Neni 2

Radiodifuzeri, për të bërë emetim të radios ose televiziv në rajonin për të cilën e ka marrë lejen për emetim radioteleviziv nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për një nivel të caktuar të shikueshmërisë/respektivisht dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal), duhet të disponojë me pajisje dhe mjete teknike me të cilat sigurohet prodhimi dhe emetimi kualitativ i programit të tyre.

Në rast të ndërprerjeve të shpeshta ose problemeve më të mëdha teknike që ndikojnë në kualitetin e programit të prodhuar, radiodifuzeri duhet ta njoftojë Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Për emetimin e programit të vet, radiodifuzerët mund të përdorin radiofrekuenca, kapacitet të multipleksit digjital terestrial, satelit ose kapacitet nga operator të rrjetit të komunikimit publik elektronik që nuk përdorin resurse të kufizuara.

Çdo radiodifuzer në hapësirat e tij duhet të posedon furnizim të pandërprerë me energji elektrike, me të cilën do të sigurojë pavarësi energjitike për funksionimin e funksioneve themelore të radiodifuzerit, respektivisht emetim pa pagesa të programit. Varësisht nga niveli i shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal), radiodifuzerët duhet të plotësojnë këto kritere në aspekt të furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike:

- për nivel rajonal dhe lokal: pavarësi të plotë energjitike prej të paktën 1 (një) orë;
- për nivel shtetëror: pavarësi të plotë energjitike prej të paktën 6 (gjashtë) orë.

Pavarësi energjitike mund të arrihet gjithashtu me përdorim të pajisjes për furnizim të vazhdueshëm të energjisë elektrike, gjenerator ose burim tjetër alternative të energjisë elektrike.

III. KUSHTET PËR SHËRBIMET E PROGRAMEVE TË RADIOS (RADIOVE)

Kushtet, standartet dhe parametrat themelore teknike

Studio

Neni 3

Çdo radio që planifikon që në shërbimin e vet programor të prodhojë fjalë dhe/ose muzikë në emetim të drejtpërdrejtë ose të prolonguar në hapësirat e tyre, duhet të ketë hapësirë të studios së përpunuar akustike-studio.

Parametrat e përbashkët për studiot janë:

- Studio duhet të ketë përpunim akustik dhe e izoluar nga zhurma e jashtme (me qëllim që të mos ketë interefirm të zërave); dhe
- përdorim i detyrueshëm i ventilimit ose aklimatizimit (rekomandohet klimatizim/ventilim qendror).

Neni 4

Studio ose hapësira për incizim ose emetim të njoftimeve, lajmeve, deklaratave, komenteve, intervistave, bisedave, tribunave, leximeve të teksteve dhe informatave të ngjashme nga bisedat duhet të plotësojë këto kritere:

- sipërfaqja e hapësirës së përpunuar akustike nuk duhet të jetë më e vogël se 9 m²;
- nëse është e paraparë që në studio njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja duhet të rritet për të paktën 2m² për person;
- lartësia minimale e hapësirës së përpunuar akustike duhet të jetë të paktën 2,6 m.

Hapësira për regjinë

Neni 5

Hapësira për regjinë është hapësirë në të cilën, me ndihmën e paisjeve elektronike dhe elektroakustike udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet programi me përmbajtje të bisedave ose

muzikorë dhe bëhet kontrolli i sinjalit të zërit dhe sinjalit dalës.

Çdo radio detyrimisht duhet të posedojë hapësirë për regjinë.

Hapësira për regjinë duhet të plotësojë këto kriteret:

- sipërfaqja e hapësirës pas përpunimit akustik duhet të jetë të paktën 10m², me lartësi të hapësirës së përpunuar të paktën 2,6 m;
 - forma e hapësirës rekomandohet të jetë katror ose trapezoid. Për shkak të stereofonisë është e nevojshme të sigurohet hapësirë me simetri akustike;
 - hapësira për regjinë duhet të përpunohet në mënyrë akustike dhe e izoluar nga zhurmat e jashtme dhe
 - në hapësirën për regjinë duhet të ketë detyrimisht përdorim të ventilimit ose aklimatizimi.
- Nëse është e paraparë që në hapësirën për regjinë njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja e hapësirës duhet të rritet për të paktën 2 m² për person.

Neni 6

Regjia mund që njëkohësisht të përdoret edhe si studio, por pajisjet e regjisë nuk duhet të ndikojnë në kualitetin e zërit.

Në rastet kur hapësira për regjinë përdoret edhe si studio, është e nevojshme të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- sipërfaqja e hapësirës pas përpunimit akustik duhet të jetë të paktën 15 m², me lartësi të hapësirës së përpunuar të paktën 2,6 m; dhe
- nëse është e paraparë që në hapësirën për studion/regjinë njëkohësisht të marrin pjesë më shumë se dy persona, sipërfaqja e hapësirës duhet të rritet të paktën 2 m² për person.

Hapësirat plotësuese

Neni 7

Çdo radio për rajonin për të cilin ka marrë leje, respektivisht për një nivel të caktuar të dëgjueshmërisë (nivel shtetëror, rajonal ose lokal) dhe që planifikon në shërbimin e saj programor, përveç përmbajtjeve të incizuara paraprake nga produksion tjetër, të emetojë edhe program personal prodhuar drejtpërdrejtë ose në mënyrë të prolonguar, duhet detyrimisht të posedojë:

- hapësirë për redaksinë (hapësira për gazetarë);
- hapësirë për drejtuesin ose kryeredaktorin dhe
- hapësirën për sistemim të pajisjeve tekniko-informative.

Redaksia dhe hapësirë për drejtuesin ose kryeredaktorin, mund të bashkohen në një hapësirë.

Kualiteti i sinjalit

Neni 8

Audio sinjali duhet të emetohet të paktën në teknikë stereofonike, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me materiale historike, të incizuara në mënyrë monofonike.

Çdo radiodifuzer duhet të posedojë metodë për rregullimin e dinamikës së zhurmës dhe tonit.

IV. KUSHTET KADROVIKE Numri dhe struktura e të punësuarve

Neni 9

Poseduesi i lejes për emetim në radio është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë të paktën:

- 1) 10 (dhjetë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim folëse ose radio folëse-muzikore në nivel shtetëror;
- 2) 7 (shtatë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim muzikor ose radio folëse-muzikore në nivel shtetëror;
- 3) 4 (katër) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim folëse ose radio folëse-muzikore në nivel rajonal;
- 4) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim muzikor ose radio folëse-muzikore në nivel rajonal;
- 5) 2 (dy) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim programor në nivel lokal, për zonë me mbi 50.000 banorë;
- 6) 1 (një) person që merr pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetim programor në nivel lokal, për zonë me më pak se 50.000 banorë.

Redaktori përgjegjës (kryeredaktori) i shërbimit programor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e cekur në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni duhet të jenë të punësuar në transmetues me orar të plotë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie pune.

Personat që marrin pjesë në krijimin e programit janë gazetarët, moderatorët, teknikë të pajisjeve për incizim dhe transmetim të zërit, montazhierë, si dhe persona të punësuar në vende të tjera të punës që lidhen drejtpërdrejtë me krijimin e programit.

Përmbushja e kushteve minimale kadrovike dëshmohet me dorëzimin e dokumentit Lajmërim/Çlajmërim në sigurimin shoqëror të detyrueshëm – Formular M1/M2 dhënë nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

IV. KUSHTET PËR SHËRBIMIN PROGRAMOR TELEVIZIV (TLEVIZIONI)

Kushtet themelore teknike dhe hapësinore, standartet dhe parametrat për pjesën e studios së televizioneve që emetojnë program në nivel lokal dhe rajonal.

Studio

Neni 10

Çdo televizion, i cili planifikon që në shërbimin e vet programor të shfaq program të tyre të prodhuar drejtpërdrejtë ose me prolongim (lajme, biseda me mysafir, kuize etj.) patjetër duhet të ketë hapësirë të përpunuar akustike të studios – studio televizive.

Varësisht nga dedikimi dhe numri i personave që planifikohen të marrin pjesë njëherazi në studion televizive, hapësira e studios duhet patjetër të përmbush këto kriteret dhe të ketë:

- sipërfaqe të përpunuar akustike prej të paktën 25 m²
- lartësi prej të paktën 2,6 m,
- ventilim dhe aklimatizim adekuat, dhe
- niveli i ndriçimit në studio duhet të plotësojë minimumin që kërkohet sipas karakteristikave teknike të kamerave që përdoren në hapësirën adekuate.

Hapësira për regjinë

Neni 11

Hapësira e regjisë është hapësirë në të cilën me ndihmën e pajisjeve elektronike, elektroakustike dhe pajisjeve të videos, udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet program me

përmbajtje audiovizuale dhe realizohet kontroll i sinjalit dalës të audios dhe videos, bëhet kontroll i dritës në studiot dhe kontroll i kamerave.

Sipërfaqja e hapësirës për regjinë duhet të jetë të paktën 12 m².

Çdo televizion detyrimisht duhet të ketë hapësirë për regjinë.

Hapësira për montazhin

Neni 12

Hapësira për montazhin është hapësira ku bëhet montimi i emisioneve që duhet të përgatiten për emetim dhe mund të jenë pjesë e ndonjë hapësire tjetër (p.sh, hapësira e regjisë ose hapësira e redaksisë), ku bëhet finalizimi i emisioneve nga aspekti programor dhe teknik.

Hapësirat plotësuese

Neni 13

Televizionet që emetojnë program në nivel lokal dhe nivel rajonal, duhet detyrimisht të posedojnë:

- hapësirë për redaksinë (hapësira për gazetarë);
- hapësirë për drejtuesin ose kryeredaktorin dhe
- hapësirën për sistemim të pajisjeve tekniko-informatike. Kjo hapësirë mund të jetë pjesë e ndonjë hapësire tjetër.

Kushtet themelore teknike dhe hapësinore, standartet dhe parametrat për pjesën e studios së televizioneve që emetojnë program në nivel shtetëror

Kushtet hapësinore

Studio

Neni 14

Çdo televizion, i cili planifikon që në shërbimin e vet programor të emeton program të tyre të prodhuar drejtpërdrejtë ose me prolongim, detyrimisht duhet të ketë të paktën 1 (një) studio, hapësirë për përpunim akustik të studios – studio televizive.

Varësisht nga dedikimi dhe numri i personave që planifikohen të marrin pjesë njëherazi në studion televizive, hapësira e studios duhet patjetër të përmbush këto kritere dhe të ketë:

- sipërfaqe të përpunuar akustike prej të paktën 25 m²;
- lartësia duhet të jetë të paktën 2,6 m dhe
- ventilim dhe aklimatizim adekuat.

Koha e nevojshme e reverberimit në studio

Neni 15

Koha e nevojshme e reverberimit në studion televizive varet nga volumi i hapësirës. Në shtrirje prej 200 Hz deri në 4.000 Hz ajo caktohet sipas formulës në vijim:

$$T_r = 0,25 (V/V_0)^{1/3} \text{ sec};$$

Ku:

T_r – është koha e nevojshme e reverberimit e shprehur në sekonda; V është volumi i hapësirës në metër kub (m^3) dhe V_0 është volumi referent që është të paktën $100 m^3$.
Tejkalimi i lejuar nga koha e nevojshme e reverberimit, llogaritur sipas formulës së lartë në shtrirjen prej 200 Hz deri në 4.000 Hz, është +0,05 sec.

Niveli i ndriçimit në studio

Neni 16

Niveli i ndriçimit në studio duhet të plotësojë minimumin që kërkohet sipas karakteristikave teknike të kamerave që përdoren në studio.

Rekomandohet përdorimi i të ashtuquajturës dritë e ftohtë për ndriçimin e studiove.

Hapësira për regjinë

Neni 17

Hapësira e regjisë është hapësirë në të cilën me ndihmën e pajisjeve elektronike, elektroakustike dhe pajisjeve të videos, udhëhiqet, përgatitet ose prodhohet program me përmbajtje audiovizuale dhe realizohet kontroll objektiv dhe subjektiv i sinjalit dalës të audios dhe videos, bëhet kontroll i dritës në studio dhe kontroll i kamerave.

Çdo televizion detyrimisht duhet të ketë hapësirë për regjinë.

Hapësira për regjinë duhet të plotësojë kriteret e paraqitura në nenin 5 të kësaj rregullore, përveç dispozitës për sipërfaqe minimale, që duhet të jetë të paktën $12 m^2$.

Hapësira për montazhim

Neni 18

Hapësira për montazh është hapësirë ku bëhet monitorimi i emisioneve që duhet të përgatiten për emetim (kjo hapësirë mund të jetë pjesë e hapësirës për regjinë).

Izolimi akustik i studiove televizive dhe hapësirave kontrolluese

Neni 19

Studia dhe hapësira për regjinë duhet të jenë të përpunuara në mënyrë akustike dhe të izoluara nga zhurma e jashtme, si dhe nga zhurma që e shkaktojnë pajisjet për ventilim dhe aklimatizim.

Niveli i lejuar i zhurmës dhe zërave të padëshiruar në studiot televizive dhe hapësirën për regjinë në lartësi prej të paktën 1,2 metra nga dyshemeja, nuk guxon të tejkalojë vlerat e vijës HP 20 nga tabela 1.

HP Linja 20	Frekuenca (Hz)								
	31,5	63	125	250	500	1k	2k	4k	8k
	69,0	51,3	39,4	30,6	24,3	20,0	16,8	14,4	12,6

Tabela 1 – Niveli i lejuar i zhurmës -
forca e presionit të zhurmës në dB në raport me $20 \mu Pa$ - rms për nivel të oktavës.

Hapësirat plotësuese

Neni 20

- Televizionet që emetojnë program në nivel shtetëror, duhet detyrimisht të posedojnë:
- hapësirë për redaksinë (hapësira për gazetarë);
 - hapësirë për drejtuesin ose kryeredaktorin dhe
 - hapësirë për sistemim të pajisjeve tekniko-informatike. Kjo hapësirë mund të jetë pjesë e ndonjë hapësire tjetër.

VI. KUSHTET KADROVIKE

Numri dhe struktura e të punësuarve

Neni 21

Poseduesi i lejes për emetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë të paktën:

- 1) 70 (shtatëdhjetë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në nivel shtetëror nëpërmjet transmetues tokësor;
- 2) 20 (njëzetë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në nivel shtetëror nëpërmjet rrjetit elektronik të komunikimit publik që nuk përdor resurs të kufizuar ose nëpërmjet sateliti;
- 3) 7 (shtatë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në rajonin D1-Shkup;
- 4) 5 (pesë) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në regjionet: D1-Crn Vrv - Veles, D2-Stracin, D3-Turtell, D4-Boskija, D5-Pelister, D6-Mali Vllaj dhe D8-Popova Shapka;
- 5) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në regjionin D7-Stogovo;
- 6) 4 (katër) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në nivel lokal, për rajon me mbi 50.000 banorë;
- 7) 3 (tre) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në nivel lokal, për rajon prej 30.000 deri në 50.000 banorë;
- 8) 2 (dy) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për emetim të programit në nivel lokal, për rajon me nën (më pak) 30.000 banorë.

Poseduesi i lejes për emetim televiziv të shërbimit programor nga format i specializuar është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune të ketë të paktën:

- 1) 10 (dhjetë) persona nëse ka leje për emetim të programit në nivel shtetëror;
- 2) 3 (tre) persona nëse ka leje për emetim të programit në nivel rajonal;
- 3) 1 (një) person nëse ka leje për emetim të programit në nivel lokal.

Redaktori përgjegjës i shërbimit programor me format të përgjithshëm dhe të specializuar duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e cekur në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni duhet të jenë të punësuar në radiodifuzer me orar të plotë pune, sipas (në pajtim) me dispozitat e Ligjit për Marrëdhënie Pune.

Personat që marrin pjesë në krijimin e programit janë gazetarë, moderator, teknikë të pajisjeve për incizim dhe transmetim të figurës dhe zërit, incizues, montazhier, si dhe persona të punësuar në vende të tjera të punës që lidhen drejtpërdrejtë me krijimin e programit.

Përmbushja e kushteve minimale kadroviqe dëshmohet me dorëzim të dokumentit Lajmërim/Çlajmërim i detyrueshëm në sigurimin shoqëror – Formular M1/M2 e dhënë nga Agjencia për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

V. KUSHTET FINANCIARE PËR TË GJITHË RADIODIFUZERËT (RADIOT DHE TELEVISIONET)

Neni 22

Radiodifuzerët janë të obliguar që të sigurojnë mjete financiare për kryerjen pa pengesë të veprimtarisë së sigurimit të emetimit radioteleviziv për të cilën ju është dhënë leja nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që nënkupton plotësim të obligimeve parashikuar me dispozitat pozitive të ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe akteve nënligjore miratuar nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23

(neni 24 i Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio nr.01-5774/1 datë 21.11.2014)

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore ndërpritet vlefshmëria e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive, nr.01-4412/1 datë 08.11.2013 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.154/2013).

Neni 24

(neni 25 i Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio nr.01-5774/1 datë 21.11.2014)

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e 8 (tetë) nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Neni 25

(neni 4 i Rregullores nr.01-3336/1 datë 08.05.2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio nr.01-5774/1 datë 21.11.2014)

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio nr.01-5774/1 datë 21.11.2014 hyn në fuqi ditën e 8 (tetë) nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.

Neni 26

(neni 19 i Rregullores nr.01-3539/1 datë 25.09.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim televiziv dhe radio)

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për emetim televiziv dhe radio („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.172/14 dhe 76/15), hyn në fuqi ditën e 8 (tetë) nga dita e publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe të njëjtën ditë do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nr.01-3953/1

31.10.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.